

VENDIM
Nr. 447, datë 23.11.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME LEZHË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 23.11.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Lezhë (UK Lezhë), me shkresën nr. 614 prot. ERRU, datë 29.10.2021, si dhe plotësimet me shkresë përcjellëse nr. 614/1 prot., datë 5.11.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Lezhë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe “Rregulloren e licencimit”, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Lezhë ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 44 432 banorë ndërsa largimin dhe përpunimit të ujërave të ndotura e ofron për 35 016 banorë të Bashkisë Lezhë.

b) Drejtues teknik i shoqërisë z. Petrit Bardhi është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Dega Inxhinieri Mekanike në vitin 1994 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

c) Drejtuesi tjetër teknik i shoqërisë për Implantin e Përpunimit të Ujërave të Ndotura znj. Suela Lekgjonaj është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës në degën Inxhinieri Hidroteknike në vitin 2016 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Lezhë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve, si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Lezhë rekomandon:

- Shoqëria UK Lezhë në momentin e parë që do të pajiset me lejen mjedisore të tipit B duhet të dorëzojë menjëherë një kopje të saj pranë ERRU.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Lezhë sh.a. me (J68007501M), në kategoritë:
 - a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;
 - c) Kategoria D – Për trajtimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Lezhë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:
 - a) Drejtues ligjor – Zef Maçi;
 - b) Drejtues teknik – Petrit Bardhi;
 - c) Drejtues teknik – Suela Lekgjonaj.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Lezhë sh.a. është Bashkia Lezhë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare për kategoritë A, C dhe D.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Lezhë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Lezhë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani